



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 2068/2 Prot.

Vlorë më, 25.09.2024

VENDIM

Nr. 36, datë 23.09.2024

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR AKORDIMIN E TITULLIT AKADEMIK
"PROFESOR EMERITUS"**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, VKM Nr.112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" si dhe standartave shtetërore për fitimin e titujve akademike "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar, Kreu V, pika 2", si dhe referuar shkresës 1937, prot, datë, 16.09.2024, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 23.09.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren për akordimin e titullit akademik "Profesor Emeritus" sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Asoc. Denada Sota**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE

PËR AKORDIMIN E TITULLIT "Professor Emeritus"

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në aktet nënligjore në zbatim të këtij Ligji, Statutin e Universitetit të Vlorës, Rregulloren e Universitetit, Senati Akademik i Universitetit të Vlorës miraton Rregulloren për akordimin e titullit "Professor Emeritus"

Neni 1

Objekti

Kjo Rregullore ka për qëllim akordimin e titullit "Professor Emeritus" për anëtarët e personelit akademik që mbajnë titullin "Profesor", pas daljes së tyre në pension.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet bazuar në nenin 61, pika 5 të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 19, pika, gërma q) të Statutit të Universitetit të Vlorës, nenit 13, pika 17 të Rregullores të Universitetit të Vlorës, Vendimit Nr.112, datë 23.02.2018 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar.

Neni 3

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullores është të përcaktoj kushtet e fitimit të titullit "Profesor Emeritus" në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, strukturat përgjegjëse dhe rregullat standarte për kryerjen e kësaj procedure.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 4

Kushtet për akordimin e titullit "Profesor Emeritus"

Personelit akademik mund ti akordohet titulli "Profesor Emeritus" kur plotëson kushtet e mëposhtme :

- Mban titullin Profesor:
- Ka mbushur moshën e daljes në pension
- Dallohet për veprimtarinë e spikatur akademike, dhe kontribut të shquar fushën shkencore, profesionale dhe pedagogjike në karrierën e Tij.
- Ka shfaqur rezultate të larta në fushën e tij kërkimore shkencore e cila ka sjelle risi në fushën e mësimdhënies në njësinë ku ai ka kontribuar.
- Të jetë angazhuar për botime shkencore kombetare dhe ndërkombetare me faktor të lartë impakti.
- Arritjet akedimike të tij, konsiderohen të vleresueshme nga njësisia akademike:

Neni 5

Procedura për zgjedhjen e "Profesor Emeritus"

1. Propozimi për dhënien e statusit "Profesor Emeritus" bëhet nga njësisia bazë ku personeli akademik ka zhvilluar karrerën e tij akademike.
2. Propozimi i njësisë bazë i përcillet Drejtduesit të njësisë kryesore shoqëruar me rekomandimin si dhe me dosjen akademike të kandidatit për "Profesor Emeritus".
3. Drejtuesi i njësisë kryesore i përcjellë Rektorit dosjen akademike të kandidatit për "Profesor Emeritus" shoqëruar me një letër rekomanduese.
4. Pas marrjes së rekomandimit dhe dosjes akademike të kandidatit për "Profesor Emeritus", Rektori i drejtohet ministrisë përgjegjëse për arsimin.
5. Pas miratimit nga ana e ministrisë e përgjegjëse për arsimin Rektori thërret Senatin Akademik.
6. Senati Akademik shqyrton dosjen, vlerëson atë dhe i akordon kandidatit titullin "Profesor Emeritus", me 2/3 e votave të Senatit.
7. Senati Akademik miraton formatin e Çertifikatës për titullin "Profesor Emeritus".

**NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK
PROF. ASOC. DENADA SOTA**